

Historia e MAQEDONISË

Klasa e IX

1. Hyrje

Historia e Maqedonisë do të zhvillohet në klasën e IX të minoritetit maqedonas në shkollat 9- vjeçare Liqenas dhe Goricë e vogël në vitin shkollor 2008-2009. Sipas programit kjo lëndë do të zhvillohet një orë në javë ose 35 orë gjatë gjithë vitit shkollor.

Nxënësit, pasi të kenë marrë njohuri nga Historia e Shqipërisë duhet të jenë në gjendje të krahasojnë Historinë e dy popujve fqinj , të krijojnë bindjen se edhe në rastet e mosmarrëveshjeve që kanë ndodhur shkaku kryesor ka qënë rezultati i Qarqeve të veçanta dhe jo i dy popujve fqinj. Lënda Historia e Maqedonisë duhet të edukojë tek nxënësit ndjenjën e miqësisë , respektit të ndërsjelltë ndërmjet dy popujve tanë, si faktor stabiliteti në Ballkan dhe integritit të të dy vendeve në familjen evropiane. Programi i kësaj lënde është parë të jetë tërheqës, i kapshëm, i çliruar nga hollësisat dhe në përshtatje me moshën e nxënësve.

Objektivat e përgjithshme dhe ato kryesore të kësaj disipline shkollore përfaqësojnë standarte shtetërore të formimit historik të nxënësve të cilat janë të detyrueshme për t'u realizuar.

2. Synime të përgjithshme të lëndës

Objekti i studimit të lëndës Historia e Maqedonisë është në përshtatje me moshën , pasqyrimin në mënyrë objektive të momenteve më të rëndësishme të zhvillimit historik të Maqedonisë, nga lashtësia deri në ditët tona, përfshi këtu përpjekjet , arritjet dhe zhvillimet në fushën e ekonomisë, shkencës , arsimit, kulturës si dhe në marrëdhëniet me popujt fqinj.

Në përfundim të kësaj klase nxënësi duhet :

- 1) Të nderojë dhe të jetë krenar për Shqipërinë, vendin ku jeton si dhe për Maqedoninë shtetin mëmë.
- 2) Të jetë tolerant, të pranojë ndryshueshmërinë dhe të jetë urë miqësie midis dy popujve fqinj .
- 3) Të edukohet me frymën e bashkëpunimit , me ndjenjën e miqësisë dhe respektit të ndërsjelltë midis dy popujve.
- 4) Të bëhet i vetëdijshëm se populli maqedonas dhe ai shqiptar gjatë bashkëjetesës kanë dhënë dhe marrë nga njëri-tjetri në fusha të ndryshme si ; arsim, art, kulturë etj.
- 5) Të forcojë më tej bindjen se minoriteti maqedonas në Shqipëri dhe ai shqiptar në Maqedoni shërbejnë si ura lidhëse dhe bashkëpunimi ndërmjet dy popujve tanë.

3. Objektivat kryesore të lëndës

Nxënësi duhet të jetë në gjendje :

- 1) Të shpjegojë arsyet e copëtimit të Maqedonisë në periudha të ndryshme historike dhe statuti i saj aktual politik.
- 2) Të dijë të përshkruajë , analizojë dhe shpjegojë shkaqet dhe rezultatet e ngjarjeve historike në Maqedoni nga lashtësia deri në ditët tona.
- 3) Të përvetësojë brenda kufijve të parashikuara në program konceptet kryesore historike të lëndës si : rendi skllavopronar , perandori , mbretëri etj.
- 4) Të jetë në gjendje të vlerësojë rolin e rëndësishëm që kanë luajtur personalitete të shquara në zhvillime të rëndësishme historike të popullit maqedonas.
- 5) Të vendosë ngjarje dhe figura historike brenda kufijve kronologjikë të parashikuara në program.
- 6) Të përdorë fjalë dhe shprehje që i përkasin periudhave të ndryshme historike.
- 7) Të dijë të vlerësojë rëndësinë e ngjarjeve historike që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kombit maqedonas.
- 8) Të jetë në gjendje të tregojë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet problemeve ekonomike , politike dhe sociale në periudha të ndryshme historike.
- 9) Të jetë në gjendje të dallojë shkaku nga pasoja dhe lidhjet që ekzistojnë ndërmjet tyre.
- 10) Të jetë i aftë që krahas tekstit të përdorë dhe burime të tjera informacioni si : harta historike , foto etj.
- 11) Të jetë në gjendje të ilustrojë ngjarje dhe figura të ndryshme historike të cilat lidhen me historinë e krahinës së tij.
- 12) Të dijë të përzgjedhë dhe të organizojë informacionin historik ku të përfshihen konceptet historike të studjuara.
- 13) Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i komunikojë nëpërmjet teknikave të tilla si : shpjegimi, përshkrimi etj.

4. Linjat dhe nënlinjat e përmbatjes

1. Njohuri të reja	26 orë
2. Përsëritje	4 orë
3. Orë në dispozicion	3 orë
4. Testime	2 orë
Gjithsej	35 orë

Nr	Kapitulli	Orët
1	Maqedonia në lashtësi	5 orë
2	Maqedonia në shekujt VII-XIV	5 orë
3	Maqedonia nën sundimin Osman	3 orë
4	Maqedonia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX	7 orë
5	Maqedonia në vitet 1918 –1990	6 orë

5. Aftësitë kryesore sipas linjave dhe nënlinjave

Në kapitullin e I - rë “ Maqedonia në lashtësi ” nxënësi duhet :

- 1) Të dijë hartën politike , fizike , demografinë dhe formimin e shtetit maqedonas.

- 2) Të analizojë momentet kryesore si dhe shkaqet e forcimit të shtetit maqedonas në kohën e Filipit të II si dhe marrëdhëniet e tij me Ilirët.
- 3) Të dijë rolin e Aleksandrit të madh në zgjerimin e Perandorisë maqedonase si dhe të analizojë shkaqet e rënies së saj.
- 4) Të kuptojë lidhjen midis gjuhës , kulturës dhe besimit të popullit maqedonas me fqinjët e vet.

Në kapitullin e II - të “Maqedonia në shekujt VII-XIV” nxënësi duhet :

- 1) Të dijë kohën dhe kushtet e krijimit të Mbretërisë së Samoillit , organizimin e saj administrativ, lulëzimin dhe zgjerimin e saj.
- 2) Të analizojë shkaqet e rënies së kësaj Mbretërie , shndërimin e Maqedonisë në një provincë Bizantine si dhe qëndresën e popullit maqedonas kundër pushtimit Bizantin.

Në kapitullin e III - të “Maqedonia nën sundimin Osman” nxënësi duhet :

- 1) Të analizojë momentet kryesore të pushtimit të saj nga Perandoria osmane
- 2) Të dijë organizimin territorial të Maqedonisë nën sundimin Osman si dhe gjendja e qytetit dhe fshatit maqedonas gjatë kësaj periudhe
- 3) Të përcaktojë format kryesore të qëndresës së popullit maqedonas kundër Perandorisë osmane.
- 4) Të analizojë reformat e Tanzimatit , pasojat e tyre në Maqedoni si dhe shkaku i luftës së përbashkët të popullit maqedonas e atij shqiptar kundër pushtimit osman.

Në kapitullin e IV - të “Maqedonia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX” nxënësi duhet :

- 1) Të dijë se cili ishte qëndrimi që mbajti Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit ndaj problemi maqedonas.
- 2) Të analizojë rëndësinë e formimit të Republikës së Krushevës si dhe shkaqet e rënies së shpejtë të saj.
- 3) Të përcaktojë qëndrimin e Maqedonisë gjatë luftës së Parë e të Dytë Ballkanike. Luftën kundër copë timit të saj.

Në kapitullin e V - të “Maqedonia në vitet 1918 –1990” nxënësi duhet :

- 1) Të dijë organizimin politik të Maqedonisë në Mbretërinë Jugosllave .
- 2) Të përcaktojë qëndrimin e popullit maqedonas gjatë luftës së Dytë Botërore .
- 3) Të evidentojë bashkëpunimin e popullit maqedonas me atë shqiptar kundër armikut të tyre të përbashkët.
- 4) Të njohë statutin e Maqedonisë në Federatën jugosllave.
- 5) Të analizojë shkaqet dhe pasojat e krizës politiko-ekonomike në vend.
- 6) Të analizojë domosdoshmërinë e vendosjes së pluralizmit në jetën politike , ekonomike dhe kulturore të vendit.

6. Metodologjia e të mësuarit

Historia e Maqedonisë klasa e IX krijon mundësi të reja zbatimi të metodave dhe strategjive të ndryshme gjatë procesit mësimor-edukativ. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhen me iniciativën e mësuesit të lëndës në përshtatje me veçoritë e përmbajtjes së tmave mësimore, me bazën didaktike , me nivelin e formimit historik të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë të shumta. Metoda bazë janë shpjegimet dhe bisedat të gërshetuara me përshkrime dhe demonstrime në aspekte të veme në aspekte të veçanta dhe të domosdoshme për konkretizimin e orës së historisë. Shpjegimi i përsosur nga mësuesi , përdorimi bazës materiale-didaktike ku vendin kryesor e zenë hartat do të ngulisës tek nxënësi qartë dhe saktë përmbajtjen e materialit lëndor dhe do të zgjeronte horizontin historik të tij.

7. Zbatimi i kurrikulës së lirë .

Ky aspekt ka për qëllim t'i lërë hapësirë të lirë krijimtarisë dhe iniciativës së mësuesit me qëllim përmbushjen sa më mirë të nevojave dhe interesave të nxënësve në përputhje me objektivat e programit, si dhe kushteve ku jetojnë e punojnë me kërkesat e kohës. Statuti i kurrikulës së lirë është i dyfishtë : i detyrueshëm dhe i ndryshueshëm.

- a) Është i detyrueshëm sepse duhet të zbatohet deri në fund të vitit shkollor bashkë me programin mësimor-edukativ.
- b) Është i ndryshueshëm sepse shpërndarja gjatë gjithë vitit dhe mbushja me materiale mësimore është në kompetencë të mësuesit të lëndës në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.

Organizimi i konkurseve , bisedave ,takimeve të hapura me historianë , studime historike të zonës së Prespës , shikime kasetash që pasqyrojnë aspekte dhe ngjarje të ndryshme të popullit maqedonas zënë një vend të rëndësishëm në këtë aspekt.

8. Lidhja ndërlëndore

Historia e Maqedonisë të klasës së IX-të të shkollës 9-vjeçare nuk mund të kuptohet dhe të konceptohet në qoftë se nxënësit nuk do të kishin marrë njohuritë ndihmëse dhe paralele për këtë shtet në lëndët e tjera.

Vetë struktura e procesit mësimor tregon se nxënësi në mënyrë indirekte merr njohuri për historinë e Maqedonisë.

Nxënësi merr njohuri nga Historia e klasës së V-të ,VI-të ; nga Gjeografia e Maqedonisë klasa e VIII-të ; Edukata shoqërore etj.

Për këtë teksti i Historisë së Maqedonisë do të hartohet në mënyrë të tillë që të përmbushë dhe të plotësojë boshllëqet e krijuara për këtë lëndë.

9. Vlerësimi

Vlerësimi është një drejtim irëndësishëm në procesin mësimor-edukativ. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë i larmishëm dhe jo i një forme të vetme. Ai duhet të përfshijë njohuri të rëndësishme dhe të evitohet ato të panevojshme.

Vlerësimi ka për qëllim :

- 1) Të sigurojë informacion identifikues për arritjet e nxënësve
- 2) Të përcaktojë përparimin e nxënësve
- 3) Të ralizojë objektoivat e përcaktuara

4) Të motivojë nxënësit

Vlerësimi nxënësve , qoftë sistematik (çdo orë mësimi), periodik (në fund të çdo kapitulli), semestral apo vjetor mund të realizohet nëpërmjet metodave dhe teknikave të ndryshme si me shkrim ashtu edhe me gojë , me veprimtari praktike , testime , zgjidhje detyrash etj.